



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:082950

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06008956

KPPP.nr.491/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Hotel Emerlad” SH.P.K., me NUI:811491563, me seli në Preoc, Graçanicë, kundër debitorit “Kosovo Legal Services Company” KLSC, L.L.C., me seli në Prishtinë, rruga “Simon Shiroka” 30C, E2/3, përfaqësuar nga B.H., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.28/2024 të datës 17.01.2024, të Përmbartuesit Privat Besnik H.Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Kosovo Legal Services Company” KLSC, L.L.C., dhe Urdhri Përmbartimor P.nr.28/2024 i datës 17.01.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Hotel Emerlad” SH.P.K., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.28/2024 të datës 17.01.2024, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.TH-11 të datës 10.10.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në afat prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, kreditorit t’ia paguaj shumën prej 5,993.69 €, me kamatëvonesë prej 8% në vit, duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës së përmbartimit. Në rast se nga ekzekutimi i llogarive bankare nuk do të arrihet përmbushja e obligimeve atëherë ekzekutimi të vazhdoj përmes ekzekutimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar se debitori është në marrëdhënie kontraktuale me Zyren e Komisionit Evropian në Kosovë, si dhe me partnerë tjerë me të cilët është duke realizuar projektin “EU Support to Kosovo Competition Authority and State Aid Commission”, andaj ky shërbim nuk është ofruar për KLSC, por për kompaninë B&S Europe dhe konzorciumin ku KLSC është partner. Tutje ka shtuar se KLSC nuk mund të paguaj këtë faturë nga fondet e saj sepse e njëjta bie në kundërshtim me rregullat PRAG për fondet IPA. Gjykatës i ka propozuar që të aprovet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri përmbarimor.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura Nr.TH-11 e datës 10.10.2023, në bazë të së cilës është mbështetur propozimi për përmbarim është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit, e rrjedhimisht propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me nenin 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm.”*

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për*

nxjerrjen e atij urdhri nga përmbauesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbauesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim” .

Bazuar në dispozitën e sipërcituar, gjykata gjeti se në rastin konkret urdhri përmbauesi P.nr.28/2024 i datës 17.01.2024, është nxjerrë pa plotësimin e kushteve për lejimin e përmbauesit, ngase propozimi për përmbauesi bazohet në një dokument kopje dhe si i tillë përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbauesi, ndërsa organi përmbaues - përmbauesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbauesi nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbaues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbauesi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43, nenit 71 dhe nenit 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.491/24, datë 31.07.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.